


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Tetor 2017

**Tiranë, më 17 Nëntor 2017:** Në Tetor 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u rritur me 14,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 2,8 %, në krahasim me Shtator 2017. Importet e mallrave në Tetor 2017 arritën vlerën 57 mld lekë, duke u rritur me 14,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 7,2 %, në krahasim me Shtator 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 32 mld lekë, duke u rritur me 15,2 %, krahasuar me Tetor 2016 dhe duke u ulur me 10,7 %, në krahasim me Shtator 2017.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në dhjetë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 226 mld lekë, duke u rritur me 13,4 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 510 mld lekë, duke u rritur me 7,7 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 285 mld lekë, duke u rritur me 3,5 %, krahasuar me 2016.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 14,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +5,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,5 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,2 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2017**




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë rritur me 13,4 %, krahasuar me një vit më parë. Si dhjetëmujor të gjitha grupet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, ku ndikimin më të madh e kanë patur: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +4,3 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,8 pikë përqindje.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 14,8 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +4,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,6 me pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Prodhime druri dhe letre” me -0,3 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2017**



Si dhjetëmujor, importet janë rritur me 7,7 % krahasuar me dhjetëmujorin 2016. Të gjitha grupet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, ku ndikimin më të madh e kanë patur: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,2 pikë përqindje.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Tetor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2016 janë: Italia me (7,5 %), Kosova me (38,0 %) dhe Spanja me (81,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-21,6 %), Bullgaria me (-10,4 %) dhe Turqia me (-63,6 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (8,7 %), Kosova me (30,0 %) dhe Greqia me (6,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Holanda me (-5,4 %), Zvicër me (-50,3 %) dhe Kroacia me (-13,9 %).

Në muajin Tetor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2016 janë: Italia me (10,3 %), Turqia me (10,4 %) dhe Gjermania me (3,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-0,6 %), Greqia me (-4,2 %) dhe Spanja me (-15,6 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (5,6 %), Greqia me (11,0 %) dhe Turqia me (11,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-7,3 %), Kina me (-5,0 %) dhe Franca me (-7,9 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 65,8 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,2 %), Turqia (6,4 %), Gjermania (6,1 %) dhe Greqia (6,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin 2017, me vendet e BE zënë 65,8 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,3 %), Greqia (7,0 %), Gjermania (7,0 %) dhe Kina (6,3 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave**

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-21	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	05 - 15	24	-4,8	44	-8,0	-20	54,3
	06 - 15	24	7,4	49	-0,8	-25	49,3
	07 - 15	23	-1,6	52	11,1	-29	43,0
	08 - 15	15	-17,3	40	-10,0	-25	38,3
	09 - 15	20	-4,3	44	-7,1	-24	46,3
	10 - 15	20	-9,3	50	-4,2	-30	40,2
	Janar – Tetor 2015	206	-4,3	442	-1,7	-236	46,5
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-19	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-27	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-31	35,3
	09 - 16	21	0,9	48	9,3	-27	42,8
	10 - 16	22	7,3	50	-0,8	-28	43,5
	Janar – Tetor 2016	199	-3,5	474	7,1	-275	41,9
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-32	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	10 - 17	25	14,2	57	14,8	-32	43,3
	Janar – Tetor 2017	226	13,4	510	7,7	-284	44,2

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Tet-16	Tet -17	Jan.- Tet. 2016	Jan.-Tet. 2017	Tet-16	Tet -17	Jan.- Tet. 2016	Jan.-Tet. 2017
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>16.717</b>	<b>19.319</b>	<b>157.502</b>	<b>173.396</b>	<b>31.664</b>	<b>34.600</b>	<b>297.137</b>	<b>311.125</b>
Austri	112	146	941	1.330	388	922	5.608	5.615
Mbretëri e	15	23	376	344	380	545	3.402	4.364
Gjermani	776	909	6.763	9.055	3.991	4.124	45.405	42.097
Greqi	961	1.103	9.164	9.779	4.009	3.839	37.688	41.819
Itali	12.034	12.939	110.784	120.417	15.191	16.757	138.755	146.481
Spanjë	853	1.543	5.687	12.487	1.297	1.094	10.526	11.261
Kroaci	43	89	804	692	494	521	3.453	3.704
Të tjera të	1.923	2.568	22.983	19.292	5.914	6.799	52.299	55.784
Kinë	745	584	4.945	7.288	4.266	4.243	41.300	39.242
Kosovë	1.449	2.000	13.518	17.576	471	785	4.664	6.944
Maqedonia	670	747	5.252	7.167	704	875	6.304	7.183
Rusi	9	3	61	89	762	1.153	8.938	9.501
SHBA	187	277	1.355	2.367	819	674	9.005	7.350
Turqi	394	143	1.660	1.792	4.608	5.089	37.480	41.726
Ukrainë	45	37	199	418	195	351	2.899	2.742
Zvicër	61	9	1.949	969	567	1.432	5.863	10.070
Të tjera	1.405	1.641	12.351	14.453	5.768	7.982	60.375	74.438
<b>Gjithsej</b>	<b>21.681</b>	<b>24.761</b>	<b>198.792</b>	<b>225.516</b>	<b>49.825</b>	<b>57.185</b>	<b>473.965</b>	<b>510.321</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tet-16	Tet -17	Jan.- Tet. 2016	Jan.-Tet. 2017	Tet-16	Tet -17	Jan.- Tet. 2016	Jan.-Tet. 2017
<b>Gjithsej</b>	<b>21.681</b>	<b>24.761</b>	<b>198.792</b>	<b>225.516</b>	<b>49.825</b>	<b>57.185</b>	<b>473.965</b>	<b>510.321</b>
Ushqime, pije, duhan	3.443	3.639	20.427	24.031	7.863	8.634	82.740	87.931
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.197	3.311	35.968	36.152	4.744	7.123	41.037	51.744
Produkte kimike dhe plastike	436	389	3.635	3.969	6.949	7.525	66.401	71.970
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	216	249	2.214	2.476	1.579	1.722	14.306	15.513
Prodhime druri dhe letre	699	815	6.259	6.603	2.216	2.080	19.160	19.536
Tekstile dhe këpucë	8.920	10.121	89.252	97.774	8.075	8.581	65.185	71.022
Materiale ndërtimi dhe	3.069	4.141	25.849	36.053	5.170	6.958	63.090	64.428
Makineri, pajisje dhe pjesë	1.095	1.421	9.340	12.244	11.244	12.242	104.910	108.341
Të tjera	605	676	5.847	6.213	1.986	2.319	17.135	19.836

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë ( milionë lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>110.784</b>	<b>120.417</b>	<b>13.518</b>	<b>17.576</b>	<b>5.687</b>	<b>12.487</b>	<b>9.164</b>	<b>9.779</b>
Ushqim, pije duhan	6.653	6.687	2.025	2.264	695	641	1.954	1.633
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	7.021	6.248	2.761	4.391	2.067	9.365	361	267
Produkte kimike dhe plastike	1.077	1.134	1.060	1.032	1	13	351	466
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.987	1.853	0	6	6	77	52	41
Prodhime druri dhe letre	4.626	4.663	277	352	5	5	733	871
Tekstile dhe këpucë	70.510	76.244	75	105	2.377	2.139	3.866	4.462
Materiale ndërtimi dhe metale	10.310	13.345	5.753	7.838	499	238	1.414	1.332
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.151	7.401	528	597	24	2	101	384
Të tjera	2.449	2.843	1.040	992	13	7	331	324

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë ( milionë lekë)**

	Itali		Gjermani		Greqi		Turqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>138.755</b>	<b>146.481</b>	<b>45.405</b>	<b>42.097</b>	<b>37.688</b>	<b>41.819</b>	<b>37.480</b>	<b>41.726</b>
Ushqim, pije duhan	14.264	15.066	3.708	3.509	11.778	11.548	4.411	4.750
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	16.124	13.593	431	720	5.260	6.365	913	1.392
Produkte kimike dhe plastike	13.855	15.391	5.576	6.393	6.339	6.663	5.346	5.998
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	11.187	12.025	3	9	121	67	311	302
Prodhime druri dhe letre	5.265	5.333	719	715	2.326	2.719	2.626	2.828
Tekstile dhe këpucë	32.682	35.249	2.194	2.177	2.986	3.256	12.194	13.045
Materiale ndërtimi dhe metale	13.871	16.493	12.501	5.407	5.464	7.710	4.980	5.072
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	26.931	28.343	18.823	21.465	2.189	2.025	5.065	6.409
Të tjera	4.577	4.989	1.450	1.702	1.225	1.465	1.634	1.930

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri